

Përshkrimi i detyrave të punës

Pozita	Trajner/e për programin e trajnimit “E drejta për përfaqësim publik-Avokimi”
Kodi i procedurës së rekrutimit	YEEP 2-02
Emërtimi i projektit ose programit	YEEP 2
Kodi dhe emërtimi i aktivitetit	A.1.2.3.3 Trajner për mbajtjen e trajnimit për Avokim
#ditëve të punës	Deri në 8 ditë pune
Periudha e angazhimit	26.09.2025-19.12.2025

Qëllimi i konsulencës

Qëllimi i konsulencës është zhvillimi i trajnimit “E drejta për përfaqësim publik-Avokimi” për grupin e parë përfitues të projektit, të përbërë nga 50 të rinj të cenueshëm. (2 grupe nga 25 pjesëmarrës)

Përshkrimi i projektit/programit

Projektin “Fuqizimi dhe aftësimi i të rinjve përmes mundësive të reja”(YEEP2) financuar nga The German Federal Ministry for Economic Cooperation and Development (BMZ), SOS Children’s Villages Worldwide, Hermann-Gmeiner Fund Germany (HGFD) YEEP-i është iniciativë dy vjeçare e dizajnuar të zhvillojë shkathtësi për punësim dhe ndërmarrësi tek të rinjtë duke krijuar botëkuptim pozitiv për të ardhmen e tyre. Projekti përqendrohet në perspektivat e përmirësuar të punësimit dhe pjesëmarrjen aktive në tregun e punës të të rinjve të cenueshëm dhe të pafavorshëm.

Përshkrimi i hollësishëm i detyrave të punës

- Përgatitja e materialeve adekuate të trajnimit dhe shumëzimi i tyre, sipas programit të KEC 045-E drejta për përfaqësim publik-Avokimi;
- Përgatitja e agjendës së trajnimit;
- Mbikëqyrja e përgatitjeve logjistike për zhvillimin e trajnimit, në veçanti sigurimi i mjeteve për trajnim;
- Zhvillimi i programit të trajnimit, sipas agjendës;
- Evidentimi i pjesëmarrësve të trajnimit;
- Shpërndarja e materialeve të trajnimit tek mësuesit;
- Përcaktimi i kriterëve vlerësues për fushatat avokuese;

- Në bashkëpunim me zyrtarët e projektit përzgjedhja e 6 fushatave avokuese të suksesshme, të cilat do i përkrah projekte grante;
- Mbledhja e informatës kthyes nga pjesëmarrësit, në formë të vlerësimit ose në formë të tjera të përshtatshme;
- Hartimi i raportit të trajnimit dhe listës për certifikim;
- Hartimi i raportit të përzgjedhjes së përfituesve të fushatës avokuese;
- Dorëzimi i raporteve dhe materialeve tjera tek menaxheri i projektit;
- Kryerja e punëve të tjera me qëllim të sigurimit të mbarëvajtjes së zhvillimit të programit të trajnimit me kërkesën e menaxherit përgjegjës;

Rezultatet e pritshme

- 1) Njoftimi i pjesëmarrësve me konceptet, qëllimet dhe hapat e qytetarisë aktive dhe përfaqësimit publik-Avokimit;
- 2) Udhëheqja e hartimit të së paku 6 fushatave avokuese dhe buxhetit nga pjesëmarrësit në trajnim;
- 3) Përzgjedhja e 6 fushata avokuese të suksesshme, të hartuara gjatë trajnimit nga pjesëmarrësit, sipas kriterëve paraprake.

Kualifikimet

- Kualifikim i nivelit baçelor;
- Njohuri dhe eksperiencë në fushën e avokimit dhe qytetarisë aktive demokratike;
- Njohuri të avancuara në përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe pakove standarde softuerike, me qëllim të organizimit të punës;
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi, në të folur dhe shkruar në gjuhën shqipe;
- Aftësi për të gjeneruar informata shtesë për të plotësuar draftimet e fushatave avokuese;
- Përvoja e mëhershme në organizimin e aktiviteteve avokuese/qytetarisë aktive (trajnime/debate/diskutime/tryeza).
- Të jetë i certifikuar nga Qendra për Arsim e Kosovës (KEC).

Orët e punës

Konsulenti i realizon ditët e punës në bazë të orarit të përcaktuar nga KEC dhe në marrëveshje me menaxherin përgjegjës të KEC.

Raportimi

Konsulenti i raporton menaxherit të projektit, Ardita Kabashi.